



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

**PROGRAM ORIENTUES  
PËR MATURËN SHTETËRORE**

(Provim me zgjedhje për shkollat e mesme artistike dega “Koreografi”)

**LËNDA:**

**HISTORI BALETI**

**Koordinatori: Majlinda Hala**

**Viti shkollor: 2014 -2015**

**TIRANË  
JANAR, 2015**

## 1. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Histori baleti” përfshin njohuritë, konceptet dhe aftësitë më të rëndësishme të historisë së baletit për shkollën e mesme artistike të sistemit 3-vjeçar.

Programi orientues për provimin me zgjedhje “Histori baleti”, mbështetet në udhëzimin Nr. 1, datë 12.01.2015 të MAS-it për “Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore 2015”, përbën një dokument të vlefshëm për shkollat e mesme artistike, dega “Koreografi”, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimin e Maturës Shtetërore.

Programi:

- Gjeneron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së baletit, që do të përgatisin maturantët për provimin “Histori së baleti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Orienton nxënësit për materialet kyçe mësimore, *njohuritë, konceptet* dhe *aftësitë kryesore* që duhet të zotërojnë ata për të përballuar me sukses provimin “Histori baleti”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Përbën, gjithashtu, një *dokument zyrtar*, që duhet zbatuar me korrekësi nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Programi orientues i historisë së baletit synon vlerësimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të nxënësve në këtë lëndë.

Ky program orientues është strukturuar në bazë të disa rubrikave që janë:

1. Tematikat që përshkruajnë përbajtjen e programit.
2. Përshkrimi i tematikës dhe objektivat.
3. Tabela e peshave.

Programi duhet shqyrtuar me kujdes dhe rigorozitet nga secili prej grupeve të interesuara. Kujdes i veçantë të bëhet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së baletit, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Vëmendje të tregojnë këta specialistë edhe në lidhje me sigurimin e balancës midis përqindjes që zë secila temë studimi në këtë program, me përqindjet që zënë këto tema në testin e provimit.

Përgatitja e nxënësve për provimin e historisë së baletit, të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, koncepteve dhe aftësive të përcaktuara në program. Për të arritur këtë, ata duhet t'u rikthehen edhe çështjeve të ndryshme, të cilat nuk janë parashikuar në program, por që përbajnë informacion bazë për të përvetësuar materialin e zgjedhur për provim.

Materiali burimor mbi të cilin duhet të punojnë nxënësit, janë leksionet që ata kanë marrë nga mësuesit e tyre apo të gjitha burimet që ata kanë përdorur gjatë viteve për shqyrtimin e përbajtjeve mësimore, të tillë si: leksione, tekste të ndryshme që kanë të bëjnë me historinë e baletit shqiptar dhe botëror, interneti etj.

## **2. TEMATIKAT E PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT**

- 1. Kërcimi në shoqërinë primitive**
- 2. Kërcimi në periudhën e Antikititetit**
- 3. Kërcimi në periudhën e Mesjetës**
- 4. Kërcimi në periudhën e Rilindjes**
- 5. Zhvillimi i baletit në Francë dhe Itali në shek. XVII-XVIII**
- 6. Baleti në periudhën e Romantizmit**
- 7. Krijimi i sistemit klasik evropian**

**8. Zhvillimi i baletit klasik në shekullin XX dhe reformat e para moderne**

**9. Baleti bashkëkohor në Evropën Perëndimore**

**10. Teatri i baletit në Amerikë**

**11. Tradita koreografike shqiptare**

**12. Krijimi i Filarmonisë Shqiptare**

**13. Baleti shqiptar**

**3. TEMATIKA**

**1. Kërcimi në shoqërinë primitive**

**Përshkrimi i tematikës:** Nëpërmjet kësaj tematike, njihen dhe analizohen elementet e para kërcyese të shoqërinë primitive. Përmes njohjes së originës së artit të kërcimit dhe kulturave të Orientit të Largët, nxënësit njihen me tiparet dalluese të kërcimit në shoqërinë primitive, me emërtimet e reja të valleve të asaj periudhe, me elementet e para, si xhesti, mimika, lëvizja, hapi kuri-kurisi dhe me vallen rituale, vallen magjike.

Nr	Tematika	Objektivat
1.	<b>Kërcimi në shoqërinë primitive</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njohin tiparet dalluese të kërcimit në shoqërinë primitive.</li><li>- njohin emërtimet e reja të valleve të asaj periudhe.</li><li>- përcaktojnë elementet e para të kërcimit dhe të tregojnë tipet e valleve.</li><li>- shpjegojnë domethënien e: <i>Xhestit.</i> <i>Mimikës.</i></li></ul>

		<p><i>Lëvizjes.</i></p> <p><i>Hapit kuri-kuri.</i></p> <p><i>Valles rituale.</i></p> <p><i>Valles magjike.</i></p>
--	--	--

## 2. Kërcimi në periudhën e Antikitetit

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e kërcimit në periudhën e Antikitetit. Përmes studimit të kësaj tematike, nxënësit njihen me kulturën e lashtë greke dhe kulturën antike të Romës, si dhe do të jenë në gjendje të shpjegojnë tematikat e valleve dhe ritmet karakteristike të tyre, të shpjegojnë natyrën e paraqitjes së spektaklevës në teatrin antik, të jepin karakteristikat e tipeve të valleve në këtë periudhë.

Nr	Tematika	Objektivat
2.	<b>Kërcimi në periudhën e Antikitetit</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojnë tematikat e valleve dhe ritmet karakteristike të tyre.</li> <li>- shpjegojnë natyrën e paraqitjes së spektaklevës në teatrin antik.</li> <li>- përcaktojnë karakteristikat e tre tipeve të valleve dhe zhvillimin e tyre në tri periudha.</li> <li>- shpjegojnë çfarë është:</li> <p><i>Teatri.</i></p> <p><i>Muzika.</i></p> <p><i>Koreografija.</i></p> <p><i>Monologu.</i></p> <p><i>Plastika.</i></p> <p><i>Mimika.</i></p> <p><i>Kërcimi Luftarake.</i></p> <p><i>Kërcimi Teatrore.</i></p> <p><i>Vallja e Kultit.</i></p> <p><i>Vallja Lirike.</i></p> </ul>

### 3. Kërcimi në Mesjetë

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e kërcimit në periudhën e Mesjetës. Përmes studimit të kësaj tematike, nxënësit njihen me llojet e ndryshme të valleve të kësaj periudhe. Gjithashtu, ata do të jenë në gjendje të shpjegojnë stilin e të kërcyerit dhe tendencat (prirjet) e para për t'u shkëputur nga feja, si dhe të përshkruajnë elementet shprehëse të hapave karakteristikë të këtyre kërcimeve.

Nr	Tematika	Objektivat
3.	Kërcimi në Mesjetë	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojnë stilin e të kërcyerit dhe tendencat e para për t'u shkëputur nga feja.</li> <li>- njojin elementet shprehëse të hapave karakteristikë të këtyre kërcimeve.</li> <li>- shpjegojnë çfarë është:  <i>Pavarësia skenike e kërcimit.</i>  <i>Kënga.</i>  <i>Deklamacioni.</i>  <i>Fantazia.</i>  <i>Pantomima.</i> </li> </ul>

### 4. Kërcimi në Rilindje

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë shqyrton dhe analizon zhvillimin e kërcimit në epokën e Rilindjes pikërisht në Itali dhe në Francë, rëndësinë e kërcimit si pjesë e rëndësishme e jetës së oborreve mbretërore dhe fisnikërisë, kërcimet kërceheshin në çift, nevojën e pranisë së baletmaestrat, si dhe lindjen e llojeve të ndryshme të kërcimit, si: *Reveranca, Promenad, Aleman, Galliard, Dance Basse, Haute dance, Pavana*, lindjen e baletit si gjini.

Nr	Tematika	Objektivat
4.	Kërcimi në Rilindje	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njihen me zhvillimin e kërcimit në periudhën e Rilindjes.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- argumentojnë rolin e kërcimit në periudhën e Rilindjes.</li> <li>- shpjegojnë nevojën për praninë e baletmaestrat.</li> <li>- përshkruajnë lindjen e koreografisë dhe etikën e kërcimit.</li> <li>- analizojnë veçoritë e kërcimit në Rilindje.</li> <li>- shpjegojnë karakteristikat e llojeve të kërcimit të kësaj periudhe.</li> <li>- analizojë faktorët që ndihmuan në lindjen e baletit si gjini.</li> </ul>
--	---

## 5. Zhvillimi i baletit në Francë dhe Itali në shek. XVII-XVIII

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë shqyrton krijimtarinë e figurave më të rëndësishme dhe reformave që ata kryen në balet, si *Zhan Zhorzh Nover apo Salvatore Vigano*, me reformat e tij si figurë gjeniale e koreografisë dhe meritat e tij si balet maestro. Nxënësit, përmes kësaj tematike, njihen edhe me veprat që figurat gjeniale kanë vënë në skenë.

Nr	Tematika	Objektivat
5.	<b>Zhvillimi i baletit në Francë dhe Itali në shek. XVII-XVIII</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njojin idetë dhe reformat e Zh. Noverit.</li> <li>- veçojnë karakteristikat si baletmaestër të S.Viganos.</li> <li>- shpjegojnë kërcimet përbërëse tek i ashtuquajturi “Baleti i Madh”.</li> <li>- shpjegojnë krijimin e Akademisë së Kërcimit.</li> <li>- analizojnë reformimin e baletit (kthimi nga argëtues në veprues).</li> <li>- shpjegojnë domethënien e: <i>operës balet dhe komedisë balet. Dramës serioze kërcyeze të pavarur nga opera. Kompozicionit masiv.</i></li> </ul>

## 6. Baleti në periudhën e Romantizmit

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë shqyrton krijimtarinë e figurave të shquara, si koreografit Philip Talioni dhe balerinës Fani Elsler. Është pikërisht periudha e Romantizmit, që përcakton mendimin poetik dhe artistik të baletit romantik, si dhe shënon lindjen e një profesionalizmi të vërtetë në balet. Në këtë periudhë, veshjet u lehtesuan dhe filloi kërcimi në majë të gishtave (puante). Nxënësit, përmes kësaj tematike, nijihen edhe me veprat që figurat e shquara të asaj periudhe kanë vënë në skenë.

Nr	Tematika	Objektivat
6.	<b>Periudha e Romantizmit</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- njohin leksikun e përdorur dhe aftësitë plastike të kërcimtarit.</li><li>- shpjegojnë stilin e kërcimit të kësaj periudhe.</li><li>- kuptojnë se mendimi poetik e artistik i baletit romantik shënoi lindjen e një profesionalizmi të vërtetë.</li><li>- kuptojnë pse lehtësimi në veshje ishte një ndryshim thelbësor.</li><li>- shpjegojnë rëndësinë e kërcimit në majë të gishtave (puante).</li><li>- analizojnë baletet kryesore të vëna nga Talioni dhe të interpretuara nga Elsleri.</li></ul>

## 7. Krijimi i sistemit klasik europian

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me sistemin e kërcimit klasik në Itali, Francë, Rusi, duke dhënë karakteristikat e baleteve të vëna në këto vende. Një vend të veçantë në këtë tematikë zë shpjegimi i pozicioneve të sakta të këmbëve, duarve, kokës, si dhe shpjegimi i teknikës së kërcimit dhe përsosmërisë në lëvizjet e reja të kërcimit si: *uljet, ngritjet, kthesat, fluturimet, rrrotullimet* në ajër etj. Nxënësit, përmes kësaj tematike, nijihen

edhe me repertorin *dhe* përdorimin e terminologjisë përkatëse (në frëngjisht) në koreografi, që do të jetë pjesë e kësaj tematike.

Nr	Tematika	Objektivat
7.	<b>Krijimi i sistemit klasik european</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin sistemin e kërcimit klasik në Itali, Francë, Rusi.</li> <li>- dallojnë karakteristikat e baleteve të vëna në këto vende.</li> <li>- rendisin repertorin artistik të Ana Pavlovës.</li> <li>- shpjegojnë pozicionet e sakta të këmbëve, duarve, kokës.</li> <li>- përcaktojnë teknikën e kërcimit dhe lëvizjet e reja të tipit kërcyes:  <i>uljet,</i>  <i>ngritjet,</i>  <i>kthesat,</i>  <i>fluturimet,</i>  <i>rrotullimet në ajër etj.</i></li> <li>-përdorin një terminologji të lëvizjeve (sot është në frëngjisht).</li> </ul>

## 8. Zhvillimi i baletit klasik në shekullin XX dhe reformat e para moderne

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me tendencat e para të largimit nga sistemi i kërcimit klasik dhe karakteristikat e stilit të kërcimit të shekullit XX. Ata njihen me dy figura të tjera të shquara që sollën risi në këtë zhanër, Mikail Fokin dhe Sidora Duka. Nxënësit njihen me ritmin plastik dhe elementet e para të kubizmit.

Nr	Tematika	Objektivat
8.	<b>Zhvillimi i baletit klasik në shekullin XX dhe</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin disa nga tendencat e para të largimit nga</li> </ul>

	<b>reformat e para moderne</b>	<p>sistemi i kërcimit klasik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojnë karakteristikat e stilit të kërcimit të shek. XX.</li> <li>- përcaktojnë të rejet që sollën Mikail Fokin dhe Isiadora Dunkan.</li> <li>- përcaktojnë ritmin plastik dhe elementet e para të kubizmin.</li> <li>- shpjegojnë domethënien e:</li> </ul> <p><i>Impresionizmit.</i></p> <p><i>Mjeteve të reja shprehëse.</i></p> <p><i>Gjimnastikës artistike.</i></p> <p><i>Mimikës shprehëse.</i></p> <p><i>Improvizimit.</i></p> <p><i>Ritmit.</i></p>
--	--------------------------------	---

## 9. Baleti bashkëkohor në Europën Perëndimore

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me disa nga tiparet e mbivendosjes së folkut mbi baletin e asaj kohe, si dhe do të përcaktojnë tipet e reja të baletit, ku rol kryesor luan folklori.

Nr	Tematika	Objektivat
9.	<b>Baleti bashkëkohor në Europën Perëndimore</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin disa nga tiparet e mbivendosjes së folkut mbi baletin e asaj kohe.</li> <li>- përcaktojnë tipet e reja të baletit, ku rol kryesor luan folklori.</li> <li>- shpjegojnë domethënien e:</li> </ul> <p><i>Shfrytëzim etik i folklorit.</i></p> <p><i>Shfrytëzim i mjeteve shprehëse të folklorit.</i></p> <p><i>Sensi kritik.</i></p>

## **10. Teatri i baletit në Amerikë**

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me disa nga tiparet e mbivendosjes së folkut mbi baletin e asaj kohe, si dhe do të përcaktojë tipet e reja të baletit, ku rol kryesor luan folklori.

Nr	Tematika	Objektivat
10.	<b>Teatri i baletit në Amerikë</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojnë influencën dhe ndikimin e artistëve të ardhur.</li> <li>- njojin meritat e Balanshin në krijimin e shkollës amerikane.</li> <li>- shpjegojnë prirjet e largimit nga sistemi klasik.</li> <li>- shpjegojnë prirjet e një "kërcimi të ri estetik".</li> <li>- shpjegojnë domethënien e: <i>Ndjenjës ritmike.</i> <i>Frymës kombëtare.</i> <i>Gjesteve ekspressive natyrale.</i> <i>Teatër në miniaturë.</i></li> </ul>

## **11. Tradita koreografike shqiptare**

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me disa nga kërcimet në fiset ilire dhe dokumentet tradicionale figurative për koreografinë shqiptare. Gjithashtu, ata njihen me shënimet letrare historike për kërcimin shqiptar në shek. XVI- XIX. Nxënësit do të përcaktojnë natyrën e valleve të para shqiptare dhe do të flasin për *vallen rituale*, *kërcimin ilir apo vallen arbëreshë*.

Nr	Tematika	Objektivat
11.	<b>Tradita koreografike shqiptare</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njojin natyrën e valleve të para shqiptare.</li> <li>- përcaktojnë tiparet karakteristike të valleve të para shqiptare.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegojnë domethënien e:</li> </ul> <p style="text-align: center;"><i>Valle rituale.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Kërcimi ilir.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Vallja arbëreshe.</i></p>
--	--

## 12. Krijimi i Filarmonisë Shqiptare

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë i njeh nxënësit me disa nga format e reja të kërcimit shqiptar, me zhvillimin e teknikës profesionale të trupës së baletit, apo elementet e folklorit kërcyes shqiptar. Përmes njohjes së tyre, nxënësit do të përcaktojnë stilin e veprave të vëna në ato vite në skenën shqiptare, do të dallojnë tematikën e veprave kërcyese, mbështetur në folklorin shqiptar, duke shpjeguar *miniaturën koncertore, operetën dhe baletin*.

Nr	Tematika	Objektivat
12.	<b>Krijimi i Filarmonisë Shqiptare</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin format e reja të kërcimit shqiptar.</li> <li>- kuptojnë zhvillimin e teknikës profesionale të trupës së baletit. Të njohin elementet e folklorit kërcyes shqiptar.</li> <li>- përcaktojnë stilin e veprave të vëna në ato vite në skenën shqiptare.</li> <li>- dallojnë tematikën e veprave kërcyese mbështetur në folklorin shqiptar.</li> <li>- Të shpjegojnë çfarë është:           <p style="text-align: center;"><i>Miniatura koncertore.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Opereta.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Baleti.</i></p> </li> </ul>

## 13. Baleti shqiptar

**Përshkrimi i tematikës:** Kjo tematikë aftëson nxënësit me argumentimin e bazave të zhvillimit të artit tonë skenik koreografik. Ata do të shpjegojnë çfarë është:

*libreti, koreografi, kompozitori dhe balerini/a.* Gjithashtu, nxënësit do të njohin dhe do të flasin për përfaqësuesit dhe veprat më të mira të krijimtarisë koreografike shqiptare.

Nr	Tematika	Objektivat
13.	<b>Baleti shqiptar</b>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin zhvillimin e baleteve shqiptare.</li> <li>- argumentojnë bazat e zhvillimit të artit tonë skenik koreografik.</li> <li>- shpjegojnë çfarë është:</li> </ul> <p style="text-align: center;"><i>Libreti.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Koreografi.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Kompozitori.</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Balerin/i,-a.</i></p>

#### 4. TABELA E PESHËS SË TEMATIKAVE NË PËRQINDJE

Tematika	Përqindja
<b>Kërcimi në shoqërinë primitive</b>	3 %
<b>Kërcimi në periudhën e Antikititetit</b>	3 %
<b>Kërcimi në Mesjetë</b>	4 %
<b>Kërcimi në Rilindje</b>	10 %
<b>Zhvillimi i baletit në Francë dhe Itali në shek. XVII-XVIII</b>	5 %
<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Zhan Zhorzh Nover</i></li> <li>- <i>Salvatore Vigano</i></li> </ul>	
<b>Baleti në periudhën e Romantizmit</b>	10 %
<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Philip Talioni</i></li> <li>- <i>Fani Elsler</i></li> </ul>	
<b>Krijimi i sistemit klasik europian</b>	10 %
<b>Zhvillimi i baletit klasik në shek. XX dhe reformat e para moderne</b>	10 %
<b>Baleti bashkëkohor në Europën Perëndimore</b>	10%

<b>Teatri i baletit në Amerikë</b>	10 %
<b>Tradita koreografike shqiptare</b>	10%
<b>Krijimi i Filarmonisë Shqiptare</b>	10%
<b>Baleti shqiptar</b>	5%
<b>Gjithsej:</b>	<b>100 %</b>